



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 19.03.2021, mori në shqyrtim praktikatat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar”.
2. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l., Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 32, datë 04.02.2021.
3. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Europian 2017/2195”.